REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT**
**DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE KORÇË**

**Nr. ______ Prot.** **KORÇË, më ___.___.2026**

# Relacion

## Projekt restaurimi

## ''Restaurimi i monumentit të Themistokli Gërmenjit, Korçë''




Adresa: Lagjia 11, Rruga ''Lefter Serafini'', Korcë, Shqipëri, E-mail info@drtkkorce.gov.al

# PERMBAJTJA

**1.VENDNDODHJA** ........ **3**

**2.ANALIZA HISTORIKO-ARKITEKTONIKE E MONUMENTIT** ........ **4**

2.1 Të dhëna historike dhe arkitektonike ........ 4

2.2 Teknikat e konstruksionit........ 4

**3.DOKUMENTIMI FOTOGRAFIK DHE GRAFIK**........ **5**

**4.GJENDJA E MONUMENTIT** ........ **10**

4.1 Dëmtimet dhe shkaqet........ 10

4.2 Ndërhyrjet konservuese dhe restauruese........ 10

**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT**
**DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE KORÇË**

## 1.VENDNDODHJA

**Kategoria** : Monument Kulture i Kategorisë I (Statuja)

**Shpallur** : Me vendim NR. 6-DT.15.01.1963 me institucion të shpalljes "Rektorati I Universitetit shtetëror"

**Gjinia** : Vepra arti të luajtshme

**Vendndodhja** : Blv. "Republika", bashta Th.Gërmenji, Korçë

Monumenti i patriotit të shquar Themistokli Gërmenji ndodhet përgjate bulevardit kryesor të qytetit, Bulevard "Republika" në lulishten me të njejtin emër, e cila ndodhet në zonën karakteristike të Korçës. Ky monument është i gjithi derdhur në bronx.




POZICIONI I MONUMENTEVE NE ZONEN E MBROJTUR




VENDNDODHJA E MONUMENTEVE/ ORTOFOTO



## 2. ANALIZA HISTORIKO – ARKITEKTONIKE E MONUMENTIT

### 2.1. Të dhëna historike dhe arkitektonike

Ky monument është shpallur objekt Monument Kulture i Kategorisë së Parë me vendim Nr.6, dt. 15.01.1963.
Statuja e patriotit te shquar Themistokli Germenji ngrihet mbi nje bazament me pllaka guri, kurse i gjithë monumenti është i derdhur i gjithi  në bronx.










### 2.2. Teknikat e konstruksionit

Monumenti i derdhur i gjithi në bronx, mbështetet mbi një bazament I veshur me pllaka graniti. Shtrimi I hapësirës në të cilën ndodhet monumenti, është e shtruar me kalldrëm.

## 3. DOKUMENTIMI FOTOGRAFIK DHE GRAFIK









**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT**
**DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE KORÇË**



oksidimi i monumentit nga kushtet atmosferike

demtime te pllakave per shkak te kohes dhe kushteve atmosferike
*(pllaka jo origjinale)*



- demtime te pllakave per shkak te kohes dhe kushteve atmosferike
- nderhyrje me llac cimento mbi pllake guri

*(pllaka jo origjinale)*



- demtime te pllakave per shkak te kohes dhe kushteve atmosferike
- nderhyrje me llac cimento mbi pllake guri per te mbushur hapesirat midis pllakave

*(pllaka jo origjinale)*




- demtime te pllakave per shkak te kohes dhe kushteve atmosferike
- shpelarje e materialit lidhes midis pllakave
- demtim i pllakave ne pjeset anesore te tyre

*(pllaka jo origjinale)*

***Shenim- Pas heqjes se pllakave ekzistuese do te verifikohet nese poshte pllakave ka mbetje te blloqeve te gurit origjinal dhe nese lind nevoja te ndryshohet projekti ne baze te gjetjeve, si dhe te kihet parasysh qe eshte vendvarrimi***

**NDERHYRJET:** Nderhyrja qe do te realizohet eshte riberja e bazamentit te monumentit te patriotit Themistokli Germenji me blloqe guri si origjinali, riprodhimi i relieveve sipas fotove origjinale dhe vendosja e ndriçimit.

**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT**
**DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE KORÇË**




***Shenim- Pas heqjes se pllakave ekzistuese do te verifikohet nese poshte pllakave ka mbetje te blloqeve te gurit origjinal dhe nese lind nevoja te ndryshohet projekti ne baze te gjetjeve, si dhe te kihet parasysh qe eshte vendvarrimi***

**NDERHYRJET:** Nderhyrja qe do te realizohet eshte riberja e bazamentit te monumentit te patriotit Themistokli Germenji me blloqe guri si origjinali, riprodhimi i relieveve sipas fotove origjinale dhe vendosja e ndriçimit.













***Shenim- Pas heqjes se pllakave ekzistuese do te verifikohet nese poshte pllakave ka mbetje te blloqeve te gurit origjinal dhe nese lind nevoja te ndryshohet projekti ne baze te gjetjeve, si dhe te kihet parasysh qe eshte vendvarrimi***

**NDERHYRJET:** Nderhyrja qe do te realizohet eshte riberja e bazamentit te monumentit te patriotit Themistokli Germenji me blloqe guri si origjinali, riprodhimi i relieveve sipas fotove origjinale dhe vendosja e ndriçimit.












***Shenim- Pas heqjes se pllakave ekzistuese do te verifikohet nese poshte pllakave ka mbetje te blloqeve te gurit origjinal dhe nese lind nevoja te ndryshohet projekti ne baze te gjetjeve, si dhe te kihet parasysh qe eshte vendvarrimi***

**NDERHYRJET:** Nderhyrja qe do te realizohet eshte riberja e bazamentit te monumentit te patriotit Themistokli Germenji me blloqe guri si origjinali, riprodhimi i relieveve sipas fotove origjinale dhe vendosja e ndriçimit.

Foto të evidentimit të demtimeve të monumentit

## 4. GJENDJA E MONUMENTIT

### 4.1. Dëmtimet dhe shkaqet

Monumenti I Themistokli Gërmenjit është një monument I cili ka nevojë për restaurim dhe për këtë është realizuar projekti i restaurimit i hartuar nga DRTK Korçë. Sipas dokumentacionit grafik dëmtimet në të kanë ardhur si pasojë e kushteve atmosferike, pranisë së lagështirës ndërhyrjeve të gabuara, si dhe nga amortizimit ndër vite. Gjendja e tij paraqitet jo e mirë, nga ku kemi evidentuar dëmtimet dhe ndërhyrjet, bashkangjitur dhe me imazhet ilustruese.

**Dëmtimet janë :**

- Oksidim I materialit dhe krijimi I myshqeve për arsye të lagështirës
- Krijim I çarjeve anësore në pllakat e gurit për shak të shpëlarjes së materialit lidhës dhe shkëputjes së pllakave
- Ndërhyrje e gabuar me mbushje me llaç çimento në sipërfaqe të pllakës së gurit
- Dëmtim I pllakave për shkak të kohës dhe kushteve atmosferike
- Shpëlarje e materialit lidhës midis pllakave

### 4.2. Ndërhyrjet konservuese dhe restauruese

**Ndërhyrjet e propozuara janë :**

***Ndërhyrja që do të realizohet është ribërja e bazamentit të monumentit të patriotit Themistokli Germenji me blloqe guri si origjinali, riprodhimi I relieveve sipas fotove origjinale dhe vendosja e ndriçimit.***

- Sondazh (per verifikimin e pllakatave dhe themeleve pas heqjes se veshjes me pllaka)

*Përpara fillimit me punimet restauruese do të bëhen sondazhe për të verifikuar gjëndjen e gurëve. Veshja me pllaka graniti do të cmontohet me kujdes. Do të kryhen matje të gurëve ekzistues dhe verifikimi i gjëndjes së tyre, në bazë të matjeve do të bëhet riprodhimi i gurëve në formë blloku sipas përmasave origjinale.*

- Restaurim mur guri llaç gëlqere 1:3 (restaurim bazamenti)

*Përfshihet heqja e gurëve të mëdhenj në bazament dhe rivendosjen e tyre në të njëjtat pozicione, restaurimin e muraturës në pjesën fundore të bazamentit dhe në pjesë të caktuara ku është e nevojshme, duke mos ndryshuar teknikën e restaurimit.*

- Restaurim shtrese kalldrëmi 15-20 cm mbi shtresë llaç M-25 dhe mbushje me rërë e fugave

*Në pjesët ku është nevoja do të restaurohen gurët e kalldrëmit ekzistues dhe të konsolidohen.Në pjesët ku mungojne gurët të plotësohen me gurë të njëjtë si ekzistues në formë, ngjyrë dhe përmasë. Restaurimi i kalldrëmit do realizohet me gurët e njëjtë si origjinali të cilët do vendosen mbi shtresë llaçi 3 cm dhe më pas sipër tyre do bëhet mbushja e fugave me rërë.*

- Restaurimi i shtatores të Themistokli Gërmenjit

*-Largimi i pluhurit*

*-Heqja e dyllit të vjetër me solucion përkatës*

*-Trajtimi me acid nitrik*

*-Tonimi me solucion përkatës Sulfur Amoni Braun S*

*-Dyllosja*

***Ky proces pune përfshin të gjitha punimet që kryhen për trajtimin e monumentit dhe restaurimin e tij. Zërat janë si më sipër, është shumë e rëndësishme që gjatë zbatimit të kihet kujdes që secili nga proceset e punës të kryhet mekanikisht me radhën e përcaktuar si dhe me lëndë specifike të shënuara.***
***Për restaurimin e kësaj vepre është e domosdoshme punimet të kryhen nga mjeshtër skulptor të cilët kanë përvojë në trajtimin dhe restaurimin e veprave të artit.***

*Ky proces përfshin pastrimin e monumentit në mënyrë mekanike për largimin e pluhurit,, fërkimin me kujdes për largimin e papastërtive dhe myshqeve të krijuara dhe përgatitjen për lyerje me material specifik për mbrotje nga dëmtimet nga kushtet atmosferike. Pastrimi përfshin të gjithë sipërfaqen në të gjitha detajet që monumenti ka dhe në pjesën e poshtme. Pas pastrimit do te kryhet trajtimi me acid nitrik, tonimi me solucion përkatës Sulfur Amoni Braun S dhe dyllosja me qëllim mbrojtjen e saj.*

- Gdhendje guri si origjinali,

F.V Gure masiv i gdhendur si origjinali per formimin e bazamentit,

*Përmasimi real do të bëhet pas sondazheve në brendësi të veshjes me pllaka dhe materiali i gurit të përdorur do të jetë gur vendi si origjinali.*

- Pllakatat anesore si origjinali (reliev me bronz) modelimi artistik dhe realizimi ne bronz (2 copë) (bazamenti) +shkronjat (KORCA, T ) si dhe montimi në vend

*Ky proces përfshin modelimin  artisitik të relieveve sipas fotove origjinale me përmasa 60 cm* 80 cm sic dallohen nga foto apo 50 cm*70 cm përmasa të cilat do të verifikohen dhe nga matjet apo sondazhet në vend. Materiali do të jetë bronz, ky proces përfshin modelimin e*

*relieveve dhe derdhjen në bronz . Më pas do të bëhet montimi në vend i tyre në vendet e caktuara në gurët anësorë.*

- Punime elektrike (vendosje ndricues shtylle)

  *Ky proces pune përfshin punime elektrike dhe pajisje për ndriçimin e monumentit, i cili propozojme të jetë i drejtuar nga ana e shtatores i vendosur në* ***2 shtylla*** *elegante të montuara pranë lulishtes dhe* ***spotet në pjesën e bazamentit****.* ***Për zgjidhjen e kësaj duhet të hartohet një projekt - preventiv nga specialistët përkatës të fushës, pasi DRTKK nuk ka inxhinier elektrikë, por ka dhënë një propozim si mund të ndriçohet monumenti, bazuar në cmimet e tregut.***

- Tabelë informuese ku do të vendosen dhe emrat e kontribuesve

*Kjo tabelë do të ketë në përmbjatje përshkrimin e tabelës ekzistuese dhe në pjesën e pasme do të ketë listën e donatorëve, kontribuesve.*
*Bashkangjitur specifikimeve emrat e kontribuesve.*

Plani i monumentit



Pamja ballore




Pamja nga prapa




Pamja anesore




Pamja anesore




***Shenim- Pas heqjes se pllakave ekzistuese do te verifikohet nese poshte pllakave ka mbetje te blloqeve te gurit origjinal dhe nese lind nevoja te ndryshohet projekti ne baze te gjetjeve, si dhe te kihet parasysh qe eshte vendvarrimi***

**NDERHYRJET:** Nderhyrja qe do te realizohet eshte riberja e bazamentit te monumentit te patriotit Themistokli Germenji me blloqe guri si origjinali, riprodhimi i relieveve sipas fotove origjinale dhe vendosja e ndriçimit.

# MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
# DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE KORÇË




Foto arkivi Mirgen Shamlli










PUNIME DERDHJE RELIEVI NE BRONZ
BAZUAR NE PERMASAT E ORIGJINALIT
(percaktimi i dimensioneve pas sondazhit te kryer ne vend)



Foto arkivi Mirgen Shamlli







**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT**
**DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE KORÇË**




Projekti i propozuar per ndricimin e monumentit te Themistokli Germenjit perfshin vendosjen e dy shtyllave elegante te montuara prane lulishtes dhe spotet te jene te vendosura ne pjesen e bazamentit. Per zgjidhjen e tij, duhet te hartohet nje projekt-preventiv nga specialistet perkates te fushes, pasi DRTK Korce, nuk ka inxhinier elektrik, por ka dhene nje projekt propozim si mund te ndricohet monumenti, bazuar ne cmimet e tregut.

***<u>Shënim- Pas heqjes së pllakave ekzistuese do të verifikohet nëse poshtë pllakave ka mbetje të blloqeve të gurit origjinal dhe nëse lind nevoja të ndryshohet projekti në bazë tv gjetjeve, si dhe të kihet parasysh që është vendvarrimi.</u>***

Relatoi :

Ark. Bruna Arkaxhiu — Bruna Arkaxhiu Digitally signed by Bruna Arkaxhiu Date: 2026.05.12 15:20:16 +02'00'

Ing.Xhuljana Avdolli — Xhuljana Avdolli Digitally signed by Xhuljana Avdolli Date: 2026.05.12 15:37:15 +02'00'

Endri Haxhiu Digitally signed by Endri Haxhiu Date: 2026.06.12 13:46:27 +02'00'

Vulosur elektronikisht nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore
Date:2026/06/12 13:51:29 +02'00'
4f6e7956bfd94ef8b8f7f1add50c0bf72026061213512818040

- REPUBLIKA E SHQIPËRISË - INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE TIRANË MINISTRIA E TURIZMIT KULTURËS DHE SPORTIT



Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur elektronikisht si rezultat i një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore)